



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:055392
Datë: 10.02.2025
Numri i dokumentit: 06826099

C. nr. 990/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.B. nga Prizreni, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. S.K. nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal – Prizren, për kompensimin e pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë, më datë: **10 shkurt 2025**, merri këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padi në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja L.B. përmes të autorizuarit të saj ka paraqitur padi për kompensimin e pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal – Prizren, me të cilën ka kërkuar nga gjykata të detyron palën e paditur, që për kohën kontestuese prej hyrjes në fuqi të ligjit e deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit, në emër të pagës shtesë për punën gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë të kompensohet paditësi në shumë të cilën do ta precizonë pas marrjes së ekspertizës financiare, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e shkaktimit të dëmit e gjerë në pagesën definitive dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar. Në dispozitiv nuk e ka përcaktuar vlerën e shumës për të cilën kërkon për shkak të kompensimit të pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë.

Pasi që pala paditëse nuk ka paraqitur shumën e kompensimit të pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendeve dhe rrezikshmërisë, për të cilat kërkon kompensimi, gjykata me Aktvendim C.nr.990/2024 datë 07 qershor 2024, ka kërkuar nga pala paditëse plotësimin e padisë konkretisht ta përcaktoj qartë kërkesën sa i për ketë ditëve të punës gjatë vikendit, për çfarë periudhe kohore kërkohen, në afat prej 3 ditësh, duke e njoftuar palën paditëse për pasojat e mosveprimit sipas atij aktvendimi.

Përkundër faktit që pala paditëse e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ajo me parashtrësën e datës 24 qershor 2024, për plotësimin dhe përmirësimin e padisë nuk e ka bërë precizimin sa i përket ditëve të punës gjatë vikendit, sa ditë ka punuar dhe për cilën periudhë kohore kërkohet kompensimi në emër të rrezikshmërisë, por i ka propozuar gjykatës që

plotësimin dhe përmirësimin e padisë për ditët e punës gjatë vikendit dhe për periudhën kohore apo prezencën në punë, do ta bëjë pas nxjerrjes së ekspertizës me arsyetimin se tani është e pamundur.

Në kuptim të nenit 99 par. 2 lidhur me nenin 254 dhe 391 të LPK-së, parashihet që padia duhet të jetë e kuptueshme dhe të përmban çdo gjë që nevojitet sipas sajë, kur paditësi me padi kërkon ekzistimin e një të drejte që i takon.

Në rastin konkretë pala paditëse kërkon kompensim të pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë, mirëpo paditësi përmes të autorizuarit të tij përkundër pranimi të vendimit për përmirësim dhe plotësim të padisë, nuk i ka përcaktuar sa ditë pune ka punuar dhe në cilën periudhë kohore ka punuar, e pasi që është kërkesë kryesore e palës paditëse, atëherë vetëm me precizim të kërkesës mundet që pala e paditur përmes përgjigjes në padi të deklarohet lidhur me pretendimet e të paditurës lidhur me kërkesën kryesore dhe atë për kompensimin e pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit dhe rrezikshmërisë, e në këtë rast gjykata nuk mund të veproi sipas kësaj padie.

Pasi që pala paditëse përkundër faktit që gjykata ka kërkuar përmirësimin dhe plotësimin e padisë, nuk ka vepruar sipas atij aktvendimi. Përkundrazi, me parashtresën për plotësimin e padisë ajo nuk ka plotësuar dhe përmirësuar padinë. Gjykata në kuptim të nenit 391 par. 1 germa (g), të LPK-së vendosi të hedh poshtë padinë.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:055392, 10.02.2025

B. profesional
Ilir Sërtollaj

Gj y q t a r i,
Shaban Shala

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtron ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktvendimi.